



REPUB LIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Glllogoc
Zyra e Personelit
01Nr. 111 - 53891 dt. 14.09/2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Glllogoc/Drenas, shpallë:

KONKURS PUBLIK
Për pozitën : Zyrtar për Transport 1

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Glllogoc
Nr.referencës:	RN00005678
Pozita e punës:	Zyrtar për Transport 1
Institucioni:	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
Divizioni/njësia:	Spektori për Shërbime publike
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 10 , Koeficienti 6
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 10, Koeficienti 6, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.

Detyrat Kryesore:

1. Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësive dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e transportit dhe siguron mbarëvajtjen e punëve lidhur me shërbimet e transportit;
3. Propozon masa adekuate për zgjidhjen funksionale dhe efikase të organizimit për transportin dhe shërbimin taksit;
4. Në bashkëpunim me inspektorët komunal dhe njësit e trafikut të policisë, kontrollon dhe propozon masat e nevojshme për zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi;
5. Harton planin preliminar dhe rendin e udhëtimit për linjat urbane dhe periferike dhe në bazë të planit egzistues, propozon format e transportit;
6. Koordinon aktivitetet me kompanitë komunale dhe kontraktuese për transport dhe trafik;
7. Bashkëpunon me zyrtarët tjerë në kuadër të drejtorisë për realizimin sa më efikas të detyrave nga fushëveprimi i saj;
8. Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregullorët të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor,(aftësitë, përvoja si dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës): Diplomë universitare, pa përvojë pune ose shkollë të lartë 2 vite përvojë profesionale, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike – Komunikacion, aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion; shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet), shkathtësi hulumtuese, analitike dhe vlerësim të gjendjes reale në teren dhe zgjidhje të problemeve që krijohen gjatë menagjimit të punëve.

Vendi ku mund të merrën dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12,gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje të noterizuara dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kriterëve të konkursit.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e rishpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data **11/09/2019 deri më 25/09/2019**, për pozitën e cekur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqes së komunës dhe shpalljes në hyrje të komunës.



Udhëheqëse e Personelit

H. Bal
Anumshahe Shabani